

## **EDONA BILALI**



**Datëlindja:** 13.06.1989

**Vendlindja:** Shkodër

**Email:** Edona.Bilali@parlament.al

### **Jetëshkrimi:**

Ka përfunduar studimet në vitin 2010 në degën administrim Biznes në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës, në të cilin ka ndjekur edhe masterin profesional në Marketing. Aktualisht është duke ndjekur studimet doktorale në fushën e Marrëdhënieve Ekonomike Ndërkombëtare dhe Menaxhimit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara FH në Burgenland të Austrisë.

Gjithashtu, ka përfunduar programin një vjeçar si Audituese e Brendshme në Sektorin Publik. Ajo ka përfunduar kursin e Mikroekonomive Konkruese, një program i Harvard Business School.

Znj. Bilali ka një sërë kualifikimesh të tjera në fushat e sipërmarrjes, konkurrueshmërisë, SME-ve dhe Startupeve. Ajo është e çertifikuar ndërkombëtarisht si trajnere dhe mentore biznesi.

Kontributi i znj. Bilali në fushën e sipërmarrjes është vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë, pasi ajo ka qënë e përfshirë në disa programe për mbështetjen e ndërmarrjeve të financuara nga donatorë të huaj. Në vitin 2018 ajo është vlerësuar me titullin 'Mentorja e vitit'.

Për dy vite akademike ajo ka shërbyer si Mentore nga Biznesi në programin 'Junior Achievement'. Ajo ka mundur disburseimin e fondeve për qindra sipërmarrje vendase nga qeveria shqiptare por kryesisht nga donatorë ndërkombëtarë. Ajo është Auditore e parë në fushën e menaxhimit të cilësisë sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001:2015. Znj. Bilali ka

një eksperiencë të gjerë që nis nga administrata publike, korporata, sektori jo fitimprurës, ai privat dhe akademia.

Në vitet 2010-2011, znj. Bilali ka punuar në Ministrinë e Financave, për të kaluar më vonë në pozicionin e menaxheres së blerjes për tregjet ndërkombëtare në një nga kompanitë më të mëdha të vendit. Në vijim dhe deri në mars 2021 ka drejtuar një studio konsulente në shërbim të sipërmarrjeve dhe zhvillimit të bizneseve të reja dhe ekzistuese. Ndër vite, ajo ka qenë eksperte e kontraktuar në programe të BERZH, GIZ dhe një sërë ambasadash të huaja në vend. Së fundmi, asaj i është besuar drejtimi politik i qarkut Shkodër.

Mjedisi është një fushë ku znj. Bilali ka dhënë në vazhdimësi kontributin e saj duke qenë e pranishme përmes projekteve dhe nismave komunitare.

Z. Bilali është mandatuar për herë të parë si deputete e Kuvendit të Shqipërisë, në Qarkun Shkodër në zgjedhjet parlamentare të mbajtura në vitin 2021, në siglën e Partisë Socialiste.

Znj. Edona Bilali është aktualisht Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.